



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

RREGULLORE

PËR SHERBIMET E QENDRËS SE “AUTIZMIT”

Hartimi i kësaj rregulloreje është mbështetur në:

Ligjin Nr.139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punes", i ndryshuar, ne ligjin nr.121/2016 “Per sherbimet e kujdesit shoqeror ne RSH”, VKM Nr.563, datë 12.8.2005 "Për percaktimin e pergjegjesive të Qarkut për shperndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqeror", Udhëzimit Nr.1, datë 02.02.2007, mbi zbatimin e VKM Nr.563, datë 12.08.2005, “Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, VKQ Nr.2, date 15.02.2019, “Per perdorimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara të M.SH.M.S dhe strukturën e punonjësve në Qendrën e Trajtimit te Fëmijëve Autike 2019”, si dhe Struktura organizative për Shërbimin e Qendres së Femijeve Autikë në Elbasan, për vitin 2019.

STANDARTET E SHËRBIMEVE TE PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR (CRREGULLIM TE SPEKTRIT TE AUTIZMIT)

1. Qendra respekton të drejtat themelore dhe liritë individuale të fëmijëve, sipas Konventës Ndërkombetare për te Drejtat e Femijeve.
2. Mundëson zhvillimin e personalitetit te femijeve te Qendres, pavaresine e tyre dhe mundeson integrimin shoqëror.
3. Shërbimi që ofrohet ka në themel të tij respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të fëmijës dhe krijimin e kushteve sa më të pershtateëshme për trajtimin e femijëve.
4. Sherbimi ofrohet me efektivitet dhe cilësi, nga specialistë të kualifikuar të fushave të ndryshme, të specializuar për problematika që Qendra ka në fokus të trajtimit të saj.
5. Qendra siguron të gjitha kushtet optimale me qëllim që personeli i saj t’u përgjigjet të gjitha nevojave dhe kërkesave të fëmijëve.

Rregullorja e brendshme përmban:

- Neni 1: Qëllimi dhe karakteristikat e strukturës.

- Neni 2: Përfituesit.
- Neni 3: Kriteret e pranimit dhe largimit të fëmijëve
- Neni 4: Vlera e shërbimeve të ofruara.
- Neni 5: Personeli.
- Neni 6: Shërbimi vullnetar.
- Neni 7: Orari i hapjes dhe mbylljes së Qendrës.
- Neni 8: Dokumentacioni i brendshëm i Qendrës.
- Neni 9: Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës.
- Neni 10: Të drejtat dhe detyrimet e Prindërve.

Neni 1

QËLLIMI DHE KARAKTERISTIKAT E STRUKTURËS

Shërbimi i fëmijëve të Qendrës së “AUTIZMIT” për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar (CSA), ofron një shërbim ndihme, përkrahje në raport me shërbimet e përshtatshme, me qëllim që të ndihmojë procesin e integritit social dhe të zhvillojë funksionin Psiko-edukativ, të çdo fëmije në vecanti.

Qendra, është e kompletuar me ambiente të përshtatshme për funksionin që është krijuar. Në përberje të saj, ajo ka ambientet e nevojshme, bazë materiale të nevojshme për terapistë në grup, ambiente higjienike dhe të ndricuara në mënyrë optimale si dhe një kopësht të mirë kontrolluar. Ambientet e brendshme të qendrës janë të monitoruara nga kamera survejimi.

Neni 2

PËR FITUESIT

1. Përfituesit e shërbimit të kësaj Qendre, janë fëmijët e grupmoshës 2-11 vjeç.
2. Kapaciteti aktual i Qendrës, për zhvillimin e një pune normale, është në total 80 (tetëdhjetë) fëmijë.

Neni 3

HYRJE-DALJA NE STRUKTURE E FEMIJEVE

1. Pranimi i fëmijëve në Qender, i referohet rekomandimeve të Neuropediatrit, Peditrit, Shoqatave që punojnë me fëmijët, Zyrtat Sociale të Pushtetit Vendor.
2. Pjesëmarrja e fëmijëve në Qendër, realizohet në bazë të një orari të përcaktuar.
3. Fëmijët vijnë në qendër të shoqëruar nga prindërit dhe largohen përsëri me prindërit.

Fëmijët shkëpusin marrëdhënien me qendrën kur:

1. Nuk paraqiten në qender në mënyrë të vazhdueshme dhe të pajustificuar pa asnjë shkak objektiv.
2. Edhe për rastet kur nuk paraqiten për një kohë të shkurtër janë të detyruar të njoftojnë paraprakisht për shkaqet e arsyeshme të mosparaqitjes.

3. Prindi me vullnetin e tij të lirë vendos për largimin e fëmijës nga Qendra.
4. Puna në Qendër, nis vetëm pasi fëmija është regjistruar në Qendrën e Autizmit në Elbasan dhe pasi bëhet një vlerësim i diagnostifikimit të tij në Qendren Rajonale të Autizmit Tiranë dhe Qendren e Zhvillimit Kombëtar Mendor. Vlerësimi bëhet nga një grup multidisiplinar, i cili nxjerr përfundimet e vlerësimit. Më pas hartohet një raport psikoedukativ dhe një program për fëmijën, që do ndiqet në Qendrën e Autizmit Elbasan.

Neni 4

VLERAT E SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Aktivitetet e programuara nga Qendra duhet të kenë si synim realizimin e objektivave për të cilat flet Neni 1 i kësaj rregulloreje.

Sistemi i ofrimit të shërbimeve dhe të vlerave të kësaj rregulloreje, i përshtaten parimeve të barazisë dhe paanesisë.

Qendra duhet të garantojë barazinë e trajtimit të fëmijëve, me qëllim ndalimin e cdo diskriminimi, në lidhje me kushtet personale dhe sociale.

Shërbimet që Qendra jonë ofron janë:

- A. **Terapi individuale ABA**, ka për qëllim integrimin e fëmijëve me CSA në komunitet.
- B. **Keshillimin e Prinderve**, ka për qëllim mbështetjen e tyre psiko-emocionale.
- C. **Fizioterapi**, për fëmijet që kanë nevojë vecanta.
- D. **Terapi Logopedie**, për zhvillimin e komunikimit
- E. **Shërbimi vullnetar** dhe ëorkshope me grupe interesi

Aktivitetet e Qendres janë të ndara në:

a. *Aktivitetet të brendshme të Qendrës*, i cili i drejtohet aktivitetëve të shoqërizimit të fëmijëve në grupe.

b. *Aktivitetet të Qendres në komunitet*. Qendra duhet të nxisë ndërhyrjet brenda rrethit territorial që konsistojnë:

- Takime periodike për të sensibilizuar komunitetin lokal mbi problematikat specifike të fëmijëve me autizëm.
- Ekspozita ose cdo lloj tjetër veprimtarie, për të bërë publike aktivitetet që zhvillohen brenda në Qendër.
- Edukim dhe trajtim të vazhdueshëm të stafit, për të përfituar nga praktika e strukturave të ngritura dhe shërbimet e pranishme në rrethin territorial.

Neni 5

PERSONELI

A. KRITERET E SELEKSIONIMIT

Për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore, për t'iu përqasur sa më tepër standarteve bashkëkohore, si dhe për arritjen e qëllimeve për të cilat është krijuar qendra, për perzgjedhjen e personelit ndiqen

kritere të vecanta dhe personat e seleksionuar, punësohen ne respektim të dispozitave të Kodit të Punës.

B. CILESITE DHE FUNKSIONET PERSONELIT

Një nga synimet kryesore të qendrës është ofrimi i shërbimit profesional dhe krijimi i një mjedisi të qetë e të sigurtë, në planin njerëzor. Përfutjesit e shërbimeve marrin shërbimin e nevojshem nga një personel i certifikuar dhe kualifikuar. I gjithë personeli ka kualifikimet/kualifikohet sipas detyrave të ngarkuara me një plan individual kualifikimi. Personeli i shërbimit të kësaj qendre, emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Keshilli i Qarkut, por nuk është pjesë përberëse e strukturës së aparatit administrativ të Këshillit të Qarkut, pasi fondi i pagave miratohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale.

Rregullorja sanksionon një përshkrim pune për cdo punonjës të Qendrës, ku përcaktohen qartë përgjegjësitë, detyrat si dhe varësia hierarkike.

Koordinatori

- Menaxhon strukturën e shërbimit të trajtimit të fëmijëve me autizëm sipas rregullores përkatëse.
- Siguron që shërbimi të ketë dokumentacion të rregullt dhe konfidencial për cdo fëmijë.
- Ndjek punën dhe mbarëvajtjen e shërbimit të fëmijëve me autizëm.
- Harton raporte dhe raporton periodikisht pranë Kryeratis të Keshillit të Qarkut.
- Merr pjesë në aktivitetet që organizon ky shërbim në lidhje me problematikat që kanë personat me aftësi të kufizuara.
- Përgatit materialet për Komitetin e Vlerësimit të Nevojave dhe Përkujdesit Social.
- Organizon takime dhe workshope me punonjësit, vullnetarët dhe edukatorët e kopsheve dhe shkolla për rritjen e kapaciteteve dhe të cilësive të shërbimit.
- Ndërmerr fushata sensibilizuese me qëllim informimi rreth këtij çrregullimi dhe krijimin e sistemit referues, në shkolla, kopshte dhe qendra shëndetësore.
- Informon prindërit për ecurinë e zhvillimit të aftësive të fëmijëve.
- Vlerëson periodikisht punën e punonjësve të shërbimit të fëmijëve autik.
- Përgatit materialet e informacionet për median.
- Shpërndan punën me qëllim që të sigurohet cilësia e shërbimit në mënyrë që të realizohen në kohë objektivat e planifikuara.
- Menaxhon burimet njerëzore brenda qendrës autike duke siguruar drejtimin e tyre, monitorimin e performancës si dhe për të ndihmuar dhe disiplinuar rast pas rasti me qëllim sigurimin dhe motivimin e tyre, zhvillimit profesional dhe mirëqenies së përgjithshme.
- Përgjigjet për të siguruar kushtet optimale të terapisë përsa i përket ambientit terapeutik: higjiena, ndicimi, ruajtja e një temperature optimale etj, si dhe bazës materiale të nevojshme për terapinë.

- Garanton kushtet optimale për sigurinë totale të fëmijës me mjete bashkëkohore si psh: vendosja e kamerave për sigurisë ambientet e Qendrës.
- Sensibilizon komunitetin mbi autizmin nëpërmjet emisioneve televizive, media të tjera dhe cdo mjeti tjetër për dhënien e informacioneve të duhura.

Përgjegjës i stafit/psikolog

- Me urdhër te brendshëm koordinatori mund t'i delegojë detyrat përgjegjësit të stafit.
- Bën kontrollin në orë terapie për cdo muaj dhe kontrollon zbatimin e orarit.
- Kontrollon dosjet e terapistëve në marrëveshje me koordinatorin.
- Harton dhe ploteson buletinet mujore dhe 1 vjecare nga edukatore dhe prindër te fëmijëve.
- Merr pjesë në aktivitetet që organizon ky shërbim në lidhje me problematikat e këtij shërbimi.
- Mund të bëjë dhe terapi individuale me fëmijët

Punonjësi (sfafi mbështetës)

- Ka për detyrë të merret me anën financiare në qendër si: arkëtimin e pageses mujore nga ana e prindërve të qendrës, etj..
- Në fund të cdo muaji derdh arkëtimet e realizuara gjatë muajit në zyrën e financës së Këshillit të Qarkut.
- Përgatit liste-prezencen për cdo muaj te stafit të qendrës dhe dorezimin e tyre në zyrën e Burimeve Njerezore të Këshillit të Qarkut Elbasan, pasi është miratuar dhe nga kordinatori ose përgjegjësi.
- Merret me pjesën organizative të aktiviteteve që organizon qendra.
- Pret prindërit që janë të interesuar për informacion.
- Hap dosjen sipas kërkesave të kartelës duke marrë dhe informacionin e përgjithshëm nga prindërit për fëmijën.
- Merr lajmërimin nga prindërit në rast se fëmija do mungojë dhe nëse mungon terapistja ai/ajo lajmëron prindërin që mos e sjellë fëmijen në Qendër.
- Në bashkëpunim me kordinatorin dhe përgjegjësin rregullon orarin e terapive.
- Mbledh e raportet mujore, 6-mujore te terapistëve dhe programeve të hartuara prej tyre pasi janë kontrolluar nga përgjegjësi dhe miratuar nga kordinatori.
- Mban procesverbalet gjatë mbledhjeve të stafit dhe prindërve.
- Mund të bëjë dhe terapi individuale me fëmijët.

Punonjesi Social (A)

- Zhvillon tema informuese me prindërit e fëmijëve.
- Ka për detyrë të merret me rekrutimin e vullnetareve dhe ndjekja e tyre ne kopshtet ku jane femijet me CSA
- Mban kontaktet dhe ruan marrëdhëniet institucionale me aktorë të tjerë bashkëpunues me qendrën.
- Mban raportet me median, bën sensibilizimin në komunitet, shkolla, kopshtet, qendra shëndetsore, etj..
- Realizon organizimin e aktiviteteve, seminareve, trajnimeve te ndryshme qe zhvillon qendra.
- Ndhmon terapistët në mbajtjen e femijeve hiperaktive dhe ne moshe me te madhe.
- Ndjek projekte në bashkëpunim me DAR, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Elbasan.
- Bashkëpunon me Komisionin e Nevojave të Vecanta pranë DAR.

Punonjes social (B)

- Organizon lojra psiko-sociale për femijet me CSA.
- Realizon gjithashtu organizimin e aktiviteteve, seminareve, trajnimeve të ndryshme që zhvillon qendra.

Terapisti, Psiko-Terapisti

- Duhet të jetë një psikolog/e me funksione të analizimit, interpretimit dhe kërkimit të zgjidhjeve për t'u kujdesur ndaj nevojave të përfitueseve.
- Terapisti duhet të marrë një informcion të plotë mbi fëmijën me të cilin do të punojë.
- Në funksionet e tij ka për detyrë të ndërhyjë për parandalimin, mbështetjen dhe zgjidhejn e situatave problematike.
- Punon ngushtë me cdo aktor të përfishirë në Qendrër duke qenë mjaft I komunikueshëm.
- Përsa i takon ndërhyrjeve të nevojshme punon si në kontakt direkt me të ftuarit e strukturave të mbrojtura ashtu edhe në aktivitete të programimit dhe të konsulencës.

Puna me fëmijën kalon në 2 faza:

Faza 1: Terapisti ndërhyt me iniciativën e tij për njohjen e fëmijës në ambjentimin me rregullat e dhomes së terapisë.

Faza 2: I përket nderhyrjes individuale dhe rasteve sporadike në grup me programin ABA.

Funksionet brenda ne qendër janë:

- Terapia individuale me fëmijet përkatës (ABA)
- Terapi grupi të percaktuara për secilin femije.
- Plotësimi i raporteve javore për gjendjen e fëmijës.
- Plotësimin e raporteve mujore për arritjet e fëmijës.
- Plotësimin e raportit 6-mujor për pritshmeritë dhe punën ne vazhdim.

- Udhëzimet ditore me prindërit për punën që duhet të zhvillojë në shtëpi.
- Udhëzime dhe raporte për mesuesit dhe edukatorët në shkollat dhe kopshtet që ndjekin fëmijët.
- Vizita të vazhdueshme në kuader të bashkëpunimit me mësuesit dhe edukatorët.
- Trajnime vetëkualifikuese me stafin në qendër si dhe me prindërit për t'i mbajtur të informuar.
- Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve me edukatorët mbi depistimin e rasteve të autizmit.
- Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve për mesuesit mbështetës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Elbasan.
- Zhvillimi dhe përgatitja e trajnimeve për studentet në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” për informacione të përgjithshme mbi crregullimin.
- Bashkëpunimi në staf mbi aktivitetet e zhvilluara në qendër si për festat e fundvitit, 1 Qershori dhe Ditën Nderkombëtare të Autizmit (2 Prill).
- Bashkëpunimi në grup me logopedistin dhe psikomotoristin në rastin e fëmijëve që ndjekin këto trajtime.
- Konsulenca të vazhdueshme me stafin në mbledhjet e organizuara për këtë qëllim.
- Bashkëpunime dhe trajnime nga stafi i Qendrës Rajonale të Autizmit.

Logopedisti (specialist i crregullimeve dhe patologjive të të folurit dhe komunikimit)

Logopedisti ka për detyrë të bëjë:

- Vlerësimet paraprake dhe përcaktimin e prejardhjes së shkallës së crregullimit të të folurit.
- Terapi individuale të të folurit dhe komunikimit.
- Terapi grupi të komunikimit për bashkëpunim dhe përvetësim të rregullave të komunikimit.
- Përdorimi i pikave të komunikimit të programit ABA.
- Përdorim i komunikimit alternativ.
- Ripërpunim i programit çdo muaj.
- Bashkëpunim me specialistët e tjerë të qendrës.
- Udhëzime dhe konsulencë me prindërit e fëmijëve.
- Udhëzime dhe konsulencë me edukatorët dhe mësuesit e fëmijëve.
- Trajnime vetëkualifikuese me prindërit dhe stafin.
- Përfshihet në aktivitete sensibilizuese mbi autizmin, si dhe leksione me studentë të logopedisë dhe psikologjisë, pjesëmarrje në media etj..

Fizioterapisti

Fizioterapisti ka për detyrë të bëjë:

- Rehabilitimin e fëmijëve me deficite motore.

- Rritjen e ekuilibrit, përqendrimit, motorikës fine, mësimin e të ecurit tek fëmijët me pamundësi ecje dhe përmirësimin e posturës së trupit.
- Trajtimin e fëmijëve me hiper toni dhe hypo toni.
- Përshtatjen e femijeve me CSA me fëmijët e tjerë normal.
- Hartimin e një raporti mujor mbi punën dhe rezultatat e çdo fëmije, hartimin e një programi 6 mujor.

Neni 6

SHERBIMI VULLNETAR

Në Qendër lejohet të ketë pjesëmarrje dhe personel vullnetar. Aktiviteti i zhvilluar nga vullnetaret duhet të jetë i nderlidhur me qëllimet e secilit shërbim dhe duhet të priren në arritjen e objektivave të caktuara. Punonjesit vullnetar duhet të punojnë në bazë të një programi të në marreveshje me terapistin për aktivitetet. Ky program duhet të jetë i miratuar nga Kordinatori dhe në mungesë nga Përgjegjësi.

Neni 7

ORARI I QENDRES

Qendra është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte, nga ora 08.00 – 16.00 (me përjashtimin e ditëve që janë festa zyrtare.

Qendra është e detyruar të njoftojë paraprakisht prindërit në kohën e duhur në rastet kur ajo nuk do të funksionojë për periudha kohore të zgjatura. (festat e Vitit të Ri, Krishlindjet, shkaqe të forës madhore ose të tjera).

Neni 8

DOKUMENTACIONI I QENDRES.

Qendra duhet të disponojë dokumentacionin e mëposhtem:

1. Dokumentacioni administrativ përbehet nga:

- Rregjistri i personelit që përmban: të dhënat e gjendjes civile, vendbanimi, nr e telefonit, funksionin, orarin, marrëdhëniet e punës, oraret e terapive.
- Rregjistrat e inventarit
- Raportet psikoedukativ të fëmijëve.
- Procesverbalet e mbledhjeve të ekipit mbi rastet individuale.
- Rregjistri i pranimin të fëmijëve.
- Rregjistrimet e keshillimit të prindërve.
- Kartelat personale të femijeve të mbrojtura me parimet e fshehtësisë.
- Urdherat e brendshëm të nxjerre nga Kryetari i Keshillit të Qarkut dhe institucionet të tjera.

2. Dokumentacioni teknik përbehet nga:

- Raportet javore.
- Raportet mujore.
- Plane pune.
- Procesverbale të mbledhjeve të stafit.
- Programet e fëmijëve bashke me oraret.
- Dokumenta në lidhje me pranimin dhe largimin e fëmijëve nga Qendra.
- Rregullorja e brendshme e përgjithshme.
- Statusi i Qendrës.
- Cdo dokument tjetër i parashikuar nga LIGJET në fuqi të lëndës higjeno-sanitare dhe administrim kontabël.

Neni 9

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QENDRËS

1. Qendra ka të drejte të kerkoje cdo informacion që ka të beje me femijen, gjithmonë në kuadrin e zhvillimit dhe mbarëvajtjes së terapise. (I referohet semundjeve me natyrë organike, sjelljë agresive apo autoagresive të femijës etj).
2. Qendra ka të drejte te kerkoje nga prinderit respektimin e rregullave te paracaktuara nga vete ajo sipas marreveshjes ne fjale dhe rregullores se brendshme te saj.
3. Qendra siguron ruajtjen e sekretit profesional në lidhje me informacionet e dhena në dosjen e fëmijës, kartela, vleresimet dhe rivleresimet. Keto te fundit mund të shikohen, lexohen, studiohen vetem nga personeli i brendshem që ka kontakt me fëmijët e Qendrës. Informacioni i shqyrtuar në këto dosje prej tyre mbetet konfidencial. Nëse për arsye të vecanta duhet që te dale jashte qendrës si kerkese e të tretëve, atehere është detyrueshme të merret ne konsideratë pëlqimi i prindërve.
4. Puna brenda ambjenteve të terapise eshte programuar në baze te vleresimit dhe raportit psikoedukativ të sjelle nga Qendra Rajonale e Autizmit, Tiranë.
5. Të gjithë punonjesit e Qendrës duhet të sigurojnë ruajtjen dhe respektimin e rregullave të etikës profesionale.
6. Në marrëdhënie me fëmijët i gjithë personeli i Qendres duhet të respektoje të drejtat e tyre sipas Konventave Ndërkombetare të të Drejtave të Femijeve.
7. Terapisti/ja duhet te respektoje ne menyre rigoroze orarin e paracaktuar te terapise, si orarin e fillimit te terapise edhe te mbarimit te saj.
8. Nje here ne 3 muaj këshillohet të kryhet rivleresimi i femijes dhe të ecurise së ndërhyrjes teraupetike së zhvilluar, rivlerësim ky i kryer nga Qendra Rajonale e Autizmit, Tiranë dhe QKMZH, Tiranë.
9. Rivleresimi i komunikohet prinderve nga psikologu i qendrës, nepërmjet takimeve të përcaktuara sipas hierarkise së nevojave të femijes/ve.

10. Terapistët mbajnë lidhje me familjarët duke i informuar për ecurinë e fëmijës dhe duke i dhënë cdo fillim jave një udhezues mbi menyren se si duhet të punojë gjatë javës me fëmijën në shtëpi.
11. Qendra ofron këshillimin me prindërit e fëmijeve, takim në të cilin prindërit referojnë nevojat dhe cdo informacion tjetër për fëmijën.
12. Në rast se terapeuti mungon për shkak semundjeje apo cfarëdo lloj shkakut madhor qendra, nëpërmjet sekretarisë së saj duhet të njoftoj prinderit të pakten 24 orë përpara përveç rasteve urgjente, por në cdo rast duhet të njoftojë përpara orarit të terapisë.
13. Oraret e terapise së fëmijëve zëvendësohen në rast se:
 - Mungon terapeuti për arsye të paraqitura paraprakisht.
 - Fëmija mungon për arsye sëmundjeje e shoqëruar me raport mjekësor.
 - Fëmija mungon për arsye të ndjekjes së vizitave mjekësore brenda dhe jashtë vendit e shoqëruar me dokumentacion mjekësor përkatës të lëshuar nga mjeku.
14. Orët e terapise nuk zëvendësohen në rastet e :
 - Mungesës së fëmijës për gjatë orës se terapise që nuk shoqërohet me raport mjekësor.
 - Mungesës të fëmijës pa shkak emergjent dhe prinderit nuk lajmërojnë paraprakisht Qendrën.
 - Nëse terapia ndërpritet për arsye shëndetësore të fëmijës apo të papritura të tjera ku terapeuti gjykon se pengojnë seriozisht punën në vazhdim të terapisë.
 - Kur fëmija mungon për shkak të aktiviteteve personale të familjes si dasma, darka, pushime, etj

Neni 10

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRINDËRVE

1. Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë informacion lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e terapisë së fëmijës brenda rregullave të përcaktuara nga Qendra.
2. Prindërit kanë të drejtë të marrin pjesë në seancën e terapisë 1 herë në muaj përveç rasteve kur terapistja e shih të arsyeshme mosprezencën e prindërve.
3. Prinderit duhet të respektojnë me korrektesë oraret e përcaktuara të terapisë si në fillimin dhe në mbarimin e saj.
4. Për arsye të zhvillimit optimal të kushteve të terapise, prinderit do t'ia japin fëmijën terapistit në ambientet e Qendres dhe do largohen prej saj deri në mbarim të terapisë. Kjo ndihmon në sigurimin e qetësisë dhe krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për zhvillimin cilësor të terapisë. Fëmija si në fillimin dhe mbarimin e terapisë shoqërohet nga terapeuti për tek prindi, vetëm në rastet kur terapeuti kërkon prezencën e prindit.
5. Prindërit duhet të zbatojnë dhe të aplikojnë detyrat e dhëna nga Psikologu/Koordinatori i Qendres si dhe terapeuti përkatës i Qendres.
6. Prindërit duhet të njoftojnë në sekretarinë e qendrës 24 orë përpara në rast të mosparaqitjes së fëmijës në terapi për shkak të sëmundjes apo arsye të justifikuar.

7. Nëse prindi dyshon se fëmija është me temperature apo është vrarë aksidentalisht fizikisht mundet që të kërkojë në sekretari ndihmën e parë e cila është në dispozicion të fëmijëve dhe stafit të Qendrës.

8. Prindërit duhet të jenë në dispozicion sa herë që qendra e quan të nevojshme ndërhyrjen e tij në rast sëmundjeje të papritur të femijes, ngritje temperature, ndërrim pampers dhe cdo gjë që ka të bëjë me higjienën apo shëndetin e fëmijës.

9. Prindërit duhet të vëne në dijeni autoritetin e qendrës për cdo nevojë të fëmijës, konflikt apo mosmarrëveshje me terapistët si dhe në rastet e mitmarrjes apo rryshfetit.

10. Prindërit duhet të paguajnë paraprakisht tarifën e shërmimit për terapinë e zhvilluar duke respektuar datën e përcaktuar nga qendra.

11. Paguesa bëhet pranë sekretarisë së qendrës e shoqëruar me mandate pagesën përkatëse

12. Në rast paaftësie paguese nga prindi e vërtetuar me dokumentacionin përkatës pasi bën pjesë në ato familje në nevojë, qendra pranon fëmijën dhe shpenzimet përkatëse subvencionohen nga vetë buxheti i qendres.

13. Kjo marrëveshje prishet në rast mosrespektimit të rregullave të sipërmenduara.

14. Në rast të prishjes së marrëveshjes së sipërmendur nga prindërit, do të merren masa paraprake sipas hierarkisë së hapave të mëposhtëm:

- Lënia e një takimi me prindërit për të diskutuar dhe komunikuar arsyet e prishjes së marrëveshjes dhe rikrijimi i një marrëveshje tjetër të mundshme duke respektuar kushtet e ndërsjellta midis qendrës dhe prindërve.

- Paralajmërimi i prindërve për largimin e fëmijës/ve nga Qendra.

- Largimin nga qendra të fëmijës/ve.

Neni 11

SHFUQIZIMET

Rregullorja e Shërbimit të Qendrës së Autizmit e miratuar me VKQ Nr. 43, datë 29.03.2016, shfuqizohet.

Neni 12

HYRJA NE FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Qarkut Elbasan.

K R Y E T A R I

Bukurosh STAFA

Konc.B.Boci

B.Gremi

G.Doka

D.Dyli

